



KONTRATË PUBLIKE - FURNIZIME

TITULLI I KONTRATËS

Përshkrimi i Kontratës: **Furnizim me medale, trenerka, kupa, topa, patike etj për organizimin e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2025**

Nr. i prokurimit ¹	642-25-3020-1-3-6
Nr i Brendshëm i Prokurimit	642-25-021-1-3-6
Nr i kontrates	642-25-3020-1-3-6/C720

AUTORITETI KONTRAKTUES

Komuna e Mitrovicës Jugore

OPERATORI EKONOMIK

Operatori Ekonomik – " **INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, 10000, PRISHTINË**
Neni 1 – Lënda

- 1.1. Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me medale, trenerka, kupa, topa, patike etj për organizimin e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2025** nga " **INFINITT SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, 10000, PRISHTINË**
- 1.2. Lënda e kontratës do të jetë (**Furnizim**) nga furnizuesi sipas pikës 1.1. të kësaj kontrate.
- 1.3. Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës nga të dyja palët dhe përfundon më **31.12.2025**.
- 1.4. Vendi i kryerjes së furnizimit është: **Komuna e Mitrovicës Jugore**.

Neni 2 – Ligji i aplikueshëm

2.1. Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 – Çmimi

3.1. Çmimi i përgjithshëm i kontratës për **Furnizim me medale, trenerka, kupa, topa, patike etj për organizimin e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2025**, shprehur me numra është: **3,946.00 Euro**.

KONTRATË: Furnizim me medale, trenerka, kupa, topa, patike etj për organizimin e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2025 . Nr i Prokurimit 642-25-3020-1-3-6 dhe Nr i Brendshëm i Prok. 642-25-021-1-3-6



3.2. Çmimi i përmendur në paragrafin 3.1., duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 – Pagesat

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas furnizimeve të kryera ose shumën totale të pagesës pas pranimit të mallit (Pemë dhe Perime) dhe pas pranimit nga zyrtari përgjegjës (verifikimi i produkteve) dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri i kontratës.

(Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë).

4.2. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 – Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1. Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2. Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës

Neni 6 – Kualiteti

6.1. Kualiteti i (Furnizimeve) duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe për përshkrimin e çmimeve.

Neni 7 – Garancioni

7.1. Garancioni do të mbetet valid për 36 muaj ose 3 vite në bazë të deklaratës së Kontaktorit në ofertën e prezentuar dhe në bazë të përshkrimit të çmimit dhe ofertës së dhënë AQP-së.

Neni 8 – Vonesat në ekzekutim

8.1. Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *(të kryej ndonjë ose të gjitha shërbimet)* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *(furnizimeve)* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 – Inspektimi dhe testimi

9.1. Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë marrë dhe testoj komponentët, materialet dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfardo artikulli që përgaditet, fabrikohet ose prodhohet për tu



dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 – Nën-kontraktimi

10.1. Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 – Ndërprerja e kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.1. Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim:

- a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar;
- c) Refuzon urdhat administrativ të Autoritetit Kontraktues;
- d) Ia jep dikuj kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti Kontraktues;
- e) Falimenton;
- f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*;
- g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare;
- h) Shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 – Ndërprerja e kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1. Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti Kontraktues:

- a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë;
- b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë;
- c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 – Komunikimi



14.1. Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën (Shqipe) në katër (4) origjinale, një (1) origjinale për Autoritetin Kontraktues, një (1) origjinale për Operatorin Ekonomik, një (1) origjinale për Njesinë Kërkuese dhe një (1) origjinale për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.


Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Mitrovicë Jugore	
Emri:	Kushtrim Mehaj
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	23.05.2025
Vula:	



Për Operatorin Ekonomik:

" INFINITT " SH.P.K.,Dëshmorët e Kombit,10000, PRISHTINË	
Emri:	Astrit Uka
Pozita:	Menaxher
Emajli	infinitt.shpk@gmail.com
Nr UNIK	601614177
Nr i tel	044/974/590
Nënshkrimi:	PEC
Data:	23.05.2025
Vula:	



KUSHTET E VEÇANTA - KVK

Numri i PROKURIMIT: 642-24-11055-5-5-8 KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK

KPK		Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	1.3	Data e Fillimit të Furnizimeve është pas nënshkrimit të kontratës dhe pas kërkesës së Institucionit Parashkollor "Gëzimi Ynë"
	1.4	Data e Përfundimit është: 31/12/2025
	1.5	Vendi i kryerjes së furnizimeve është <i>Komuna e Mitrovicës JUGORE</i> (në Komunën e Mitrovicës Jugore)
Emrimi i Menaxherit të Kontratës	1.6	Menaxheri i Kontratës : Nazmi Rraci
Parimet e përgjithshme të pagesës	1.10	Orari i pagesës do të jetë: Autoriteti Kontraktues do të paguaj sipas furnizimeve të kryera ose shumën totale të pagesës pas pranimit të mallit (Pemë dhe Perime) dhe pas pranimit nga zyrtari përgjegjës (verifikimi i produkteve) dhe raportit të nënshkruar nga Menaxheri i kontratës. (Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë).
Kontrolli i kualitetit	1.11	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të furnizimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Të kontrolloj produktet a jane te freskëta dhe pesha e kerkuar a jane sipas kerkeses na AK
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	1.12	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me	1.13	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën

KONTRATË: Furnizim me medale,trenerka,kupa,topa,patike etj për organizimin eaktiviteteve sportive gjatë vitit 2025 . Nr i Prokurimit 642-25-3020-1-3-6 dhe Nr i Brendshëm i Prok. 642-25-021-1-3-6

procedure gjyqësore	Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes,gjykata apo arbitrimi.
---------------------	---

Paramasa: Furnizim me medale,trenerka,kupa,topa,patike etj për organizimin e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2025

	Pershkrimi	Njësia matëse	Sasia	Cmimi per njesi	Cmimi total
1	Medale	copë	500	1.50	750.00
2	Trenerka XS	copë	25	20.00	500.00
3	Trenerka M	Copë	20	20.00	400.00
4	Trenerka S	Copë	20	20.00	400.00
5	pipat	copë	10.00	1.20	12.00
6	Tregerat për lojë	copë	20.00	6.00	120.00
7	Ndresa për turnire	copë	50.00	9.00	450.00
8	Flamuji për kende te fushes	copë	10.00	6.50	65.00
9	Poratat e vogla 3x2	copë	2	280.00	560.00
10	Mrezhat për porta 1.5m	copë	2	12.00	24.00
11	kartonat për arbitra	copë	4	5.00	20.00
12	Patika nr 41	copë	15	22.00	330.00
13	Kupat	copë	30	7.50	225.00
14	Topat 5 , 120-450g, perimetri 68-70cm , diametri21.6-12.7cm	copë	10	9.00	90.00
	GJITHESEJT TOTALI				3946.00

Autorizim

Unë Selvije Krasniqi me nr të letërnjoftimit: 1010390482, drejtor i kompanise
INFINITT SH.P.K.- Prishtinë me nr unik te biznesit: 810860818:

AUTORIZOJ:

Albert Kosumi - perfaqesues me nr te leternjoftimit 1232181261 per nenshkrimin
e kontrates:

**Titulli: Furnizim me medale,trenerka,kupa,topa,patike etj për
organizimin e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2025**

Nr i Prokurimit: 642-25-3020-1-3-6

Autoriteti kontraktues: KUVENDI KOMUNAL MITROVICË

Autorizimi dedikohet per aktivitetin e lartecekur dhe nuk mund te perdoret per
qellime te tjera.

INFINITT SH.P.K.
Selvije Krasniqi
Drejtor


Dt. 24.05.2025



